

ETLEVA LALA

Eötvös Loránd University (ELTE)

lala.etleva@btk.elte.hu; etlevalala@yahoo.com

GJON GAZULLI**MJESHTRI I RRJETEVE SOCIALE NË MESJETËN E VONË****Abstrakt:**

Gjon Gazulli një ndër astrologët dhe humanistët më të shquar të shek. XV, është pak i njohur për aktivitetet e tij të tjera dhe sidomos për lidhjet e jashtëzakonshme shoqërore e rrjetet e tij sociale. Në këtë shkrim hidhet dritë pikërisht mbi këto rrjete sociale. Fillohet me rrjetin e tij familjar të të njohurve dhe vazhdohet me atë vendor, e konkretisht me qytetarët e Raguzës. Më pas ndriçohet një ndër aspektet më të rëndësishme të aktivitetit diplomatik të Gazullit, atë të ndërmjetësimit të Selia e Shenjtë në favor të Mbretit hungarez Zigismund të Luksemburgut për të marrë kurorën perandorake, dhe në këmbim marrjen edhe të licencës së tregtisë së lirë detare me të gjithë botën për Republikën e Raguzës, gjë që e bëri Raguzën një superfuqi. Këto lidhje diplomatike dhe politike, që ai kishte me pushtetet më të larta politike të kohës, i mundësuan atij një reputacion të pakontestueshëm në gjithë Europën e asaj kohe. Për t'u përmendur është edhe rrjeti i tij intelektual me profesorë, studiues e studentë që kultivohej në mënyrë të veçantë nëpërmjet shkëmbimit të librave dhe të dorëshkrimeve. Librat e tij, ata që zotëronte, por edhe idetë e tij, krijojnë gjithashtu një rrjet social më vete, që vazhdon të ekzistojë edhe sot e kësaj dite.

Fjalë kyçe:

Gjon Gazulli, Johannes Gazulus, network, rrjetet sociale, Republika e Raguzës, astrologjia, shqiptarët në Dalmaci, Mesjeta shqiptare, Skënderbeu, kurorëzimi i Zigismundit të Luksemburgut.

Gjon Gazulli ishte një nga humanistët dhe një nga astronomët më të shquar të shek. XV. Matematikan, astronom, diplomat dhe intelektual i përmasave europiane dhe madje botërore të asaj kohe, ai jetoi dhe punoi në Republikën e Raguzës. Gazulli ishte student dhe më vonë edhe profesor në Universitetin e Padovës; diplomat i Senatit të Raguzës të

mbreti hungarez dhe më vonë te Perandori Zigismund dhe te Selia e Shenjtë; ambasador i Skënderbeut dhe ndërmjetës i marrëdhënieve të tij me Selinë e Shenjtë dhe Perëndimin mesjetar, përveç faktit që ishte edhe astronom dhe astrolog i famshëm në atë kohë. Në këtë studim, megjithatë, do të përqendrohemi në rrjetin e jashtëzakonshëm të lidhjeve personale që Gazulli kishte krijuar dhe mënyrën se si ai e përdorte rrjetin e tij të miqësive dhe të njohjeve.

Gazulli kishte një rrjet të jashtëzakonshëm lidhjesh me studiues, personalitete politike, diplomatike, fetare dhe të tjerë, duke qenë kështu në kontakt me pushtetet më të shquara të kohës së tij. Në këtë mënyrë, direkt apo indirekt, Gazulli ndikonte me mendimin e tij në rrjedhat kohore, siç ishte p.sh. sqarimi i Selisë së Shenjtë për rrezikun kërcënues të Perandorisë Osmane, në rast se Ballkani Perëndimor binte në duart e tyre. Gazulli njihet si astronom dhe astrolog,¹ por aftësitë e tij diplomatike, që e bënë atë një ndër personalitetet më të rëndësishme të kohës së tij, janë më pak të studiuara, gjë që është edhe fokusi i këtij shkrimi.

Rrjeti i jashtëzakonshëm i lidhjeve që kishte Gazulli prezantohet në këtë studim në disa rrafshë: *1. Rrjeti familjar i të njohurve* ku Gazulli si shqiptar ishte në kontakt me shumë shqiptarë të tjerë që jetonin e punonin

¹ Për herë të parë në Shqipëri Gjon Gazullin e njohim nga një studim i studiuesit hungarez Florio Banfi, botuar në revistën *Leka*, në vitin 1939. Shih: Florio Banfi, "Ma i moçmi humanist shqiptar: Joannes Gazulus, shek. XV (Antiquissimus humanista albanensis, Joannes Gazulus, saec. XV)", *Leka*, E perkohshme muejore e Shoqatës "L.E.K.A.", vjeti XI, nr. 1-2 (Shkodër: 1939), 17-34. [Florio Banfi (*pseudonim i: László Flóris Holik që më vonë u quajt: Gyula Holik-Barabás*)]; shumë vjet më vonë, në vitin 1984, studiuesi i Mesjetës, Jahja Drançolli botoi një libërth të thukët për Gazullin të titulluar, *Gjin Gazulli, Astronom dhe diplomat i shek. XV* (Prishtinë: Rilindja, 1984); Studiuesit kroatë bëjnë vazhdimisht përpjekje për ta rehabilituar figurën pak të njohur të Gazullit në botë. Për këtë shih Jorjo Tadić, "Johannes Gazulus, dubrovački humanista XV veka", *Enciklopedija Jugoslavije* (Miroslav Krleža, ed.) *Dip – Hid*. Jugoslavenski Leksikografski zavod, vol. III (Zagreb: Leksikografski Zavod FNRJ, 1958), 434; Šime Jurić, "Prilozi biografiji Ivana Gazulića", *Anali Zavoda za povijesne znanosti Hrvatske Akademije Znanosti i Umjetnosti u Dubrovniku*, Istorijски Institut u Dubrovniku, viti VIII-IX (1962), 447-479; Mirko Dražen Grmek, & Žarko Dadić, "O astronomu Ginu Gazulu i dubrovačkom traktatu o astrolabu. (L'Astronome Gin Gazul et le traite Ragusain d'Astrolabe)", *Anali Zavoda za povijesne znanosti Hrvatske Akademije Znanosti i Umjetnosti u Dubrovniku*, Istorijски Institut u Dubrovniku, viti XIII-XIV (Dubrovnik: 1976), 53-54.

në Raguzë dhe përtej Raguzës; 2. *Rrjeti vendor i të njohurve* në Dubrovnikun e shek. XV, ku ai kishte ndërtuar një emër të mirë si qytetar raguzan, besnik ndaj Senatit dhe interesave të Republikës së Raguzës; 3. *Rrjeti i të njohurve diplomatikë*, ku kontaktet me autoritetet dhe pushtetet më të larta të kohës e vënë atë përpara përgjegjësish dhe mundësish të jashtëzakonshme; dhe 4. *Rrjeti intelektual i të njohurve me studiues, kolegë, mësues, profesorë, studentë, astrologë dhe matematikanë me famë europiane*, rrjet ky që pasurohej jo vetëm me kontaktet e vazhdueshme që ai kishte me ta, por edhe nëpërmjet shkrimeve dhe dorëshkrimeve të tij si dhe pikëpamjeve më të përparuara të asaj kohe që shpërndaheshin në të gjithë Europën. Këto rrjete në atë kohë kultivoheshin në një mënyrë shumë më personale, sesa në ditët e sotme. Në këtë network akademik të Gazullit, mund të flasim madje edhe për atë të lexuesve të librave të tij gjatë jetës dhe pas vdekjes së tij, dhe jo vetëm të tezave të shkruara prej tij, por edhe të librave që ai zotëronte.

Fama e Gazullit

Gazulli ishte i famshëm ndër astrologët dhe matematikanët e të gjitha kohërave, duke filluar që nga shek. XV, për shkak të kontributit të tij në astronomi e astrologji, që njihet si “metoda Gazulus dhe Campanus e studimit të astrologjisë.” Në këtë mënyrë, emri i Gazullit është i përjetësuar në shkencën e astrologjisë dhe të astronomisë, edhe pse asnjë nga dorëshkrimet e tij nuk është botuar deri më sot. Sigurisht, kjo ka ndodhur jo sepse nuk ka dorëshkrime të shkruara prej tij, por sepse ato janë tjetërsuar nga të tjerët, si pasojë e plagjiarizmit.

Për ekzistencën e dorëshkrimeve të Gazullit kemi disa dëshmi të pakundërshtueshme: Pannonius-i i shkruante Gazullit që e kishte marrë dorëshkrimin e tij,² dhe ishte befasuar nga përmbajtja e tij shkencore. Sigurisht, që ky dorëshkrim i Gazullit nuk iu kthye mbrapsht Gazullit pas leximit të tij, por mbeti në bibliotekën e Pannonius-it. Po kështu, Gazulli përmendet në veprat e Regiomontanus-it, një ndër astrologët më me emër të Mesjetës së Vonë, d.m.th. të shek. XV, gjë që të çon në konkluzionin se edhe ai i kishte pasur në dorë dorëshkrimet e Gazullit dhe që lehtësisht mund të konkludohet që ato kishin qarkulluar dorë më dorë dhe ishin

² Dorëshkrimi autograf i Gjon Gazullit ruhet në Arkivin Historik të Dubrovnikut, në Dubrovnik. *Državni Arhiv u Dubrovniku* (më tej: DAD), Fondi (më tej: F) Bassegli-Gozze, Rukopisi, nr. 32, 271-281.

shfrytëzuar gjerësisht nga studiuesit më me emër të asaj kohe. Megjithatë, për dorëshkrimet e Gazullit do të flasim gjerë e gjatë në një shkrim të ardhshëm.

Gazulli ishte një personalitet publik në Republikën e Raguzës, dhe si i tillë përmendet në biografinë e njerëzve të famshëm përpiluar nga Serafin Maria Cerva (1686-1759), me titullin: *Fr. Joannes Gazulius Ord. Praed.* (fra Gjon Gazulli, i Urdhrit të Prediaktorëve).³ Sefarin Maria Cerva i referohet Gazullit si burrë i shquar i doktrinës së shenjtë, mjeshtër i letrave, njeri shumë i ditur (*vir doctrinae insignis sacrae facultatis magister, vir doctissimus.*)⁴ Në shek. XIX, françeskani, atë Anton Agich, shkroi një bibliografi të plotë për Gazullin, ku na jep edhe tekstin e plotë të letrës së famshme të Jan Pannonius-it.⁵

Ka plot të dhëna të tjera që tregojnë se Gjon Gazulli ishte shumë i famshëm në Mesjetë,⁶ dhe dy ftesat që i bën vetë Mbreti hungarez, Mathias Corvinus (Matias Korvini), sapo erdhi në fronin mbretëror, e përforcojnë akoma më tepër këtë fakt. Letra e Pannonius-it daton nga viti 1460 dhe vjen pas dy refuzimeve që Gazulli u bën ftesave të Mbretit Mathias Corvinus, për të shkuar në oborrin hungarez bashkë me librat e tij. Justifikimi i tij ishin problemet shëndetësore dhe mosha e shtyrë.

Familja dhe rrjeti i shqiptarëve në Raguzën mesjetare

Sipas burimeve të Arkivit Historik të Dubrovnikut është tashmë fakt që shumë shqiptarë, veçanërisht nga Shqipëria e Veriut, në Mesjetën

³ Cerva Serafinus Maria (Serafin Marija Crijević), *Biblioteca Ragusina. In qua Ragusini scriptores gesta et scripta recensentur. Editionem principem curavit et prooemium conscripsit: Stepanus Krsić, Volumen II* (Zabreb: Academia Scientiarum et Artium Slavorum Meridionalium, 1977), 223. (më tej: S. M. Cerva, *Bibliotheca Ragusina II.*)

⁴ *Po aty.*

⁵ *DAD, 2 Memoriae nr. 51* (Át Anton Agich, *Fr. Joannes Gazulius Ord. Praed.*).

⁶ Francesco Maria Appendini, *Notizie storico-critiche sulle antichità storia e letteratura de' Ragusei*, vol. II. (Ragusa: Delle Stampe di Antonio Martecchini, Con Licenza de' Superiori, 1803), 41-42: "Il libro, di cui si parla in questa lettera, sembra dover essere stampato, e forse non é sola opera composta dal ritrovarsi nelle tavole cronologiche de Musanzio collocato il Gazoli (Gazulus Ragusaeus) tra i primi matematici del secolo XV"; Giovanni Domenico Musanti, *Tabulae Chronologicae Jo: Dominici Musantii e Societate Jesu quae Sacra, politica, bellica, fortuna, literas, et artes ad omnigenam historiam complectum*. Editio tertia. Amplissimo praesuli Nicolo Spineli episcopo Aversano D.D.D. (Romae: Excudebat Joannes generosus Salolmoni. In Foro S. Ignatii. Superiorum Permissu, 1750), 137.

e Vonë jetonin në Raguzë dhe në qytete të tjera të Dalmacisë. Në regjistrin e parë të fisnikërisë raguzane, të hartuar nga Nikolaus Ranjini në shek. XVI, nga 152 familjet fisnike raguzane 12 ishin me origjinë shqiptare, gjë që flet për statusin që gëzonin shqiptarët në Raguzë. Shumica e shqiptarëve në Raguzë e në Dalmaci kishin poste të larta kishtarë, si famullitarë apo priftërinj, rektorë apo drejtues manastiresh, por shumë prej tyre kishin edhe funksione të tjera, madje edhe të larta në jetën politike dhe kulturore të Raguzës.

Në shek. XV dhe XVI, shumë humanistë shqiptarë u dalluan në shkencë, në filozofi, në arte dhe në kulturë në përgjithësi, duke botuar veprat e tyre në qytete të ndryshme të Dalmacisë dhe në Itali. Disa nga artistët më të shquar shqiptarë, si Gjon Durrsaku, Dominik Durrsaku, Gjon Gazulli, Domenik Topia, Andrea Aleksiu (Lleshi), Marin Beçikemi nga Shkodra, drejtor i shkollës së retorikës në Raguzë, janë të njohur, por shumë të tjerë janë akoma për t'u identifikuar dhe nxjerrë në dritë, sepse siç thotë Giuseppe Gelcich,⁷ shumë monumente artistike në Dalmaci janë kryevepra të artistëve shqiptarë, dhe këtë e konfirmojnë shumë studiuues të tjerë.⁸

Nga dokumentacioni arkivor që ruhet në Arkivin Historik të Dubrovnikut në *Libri reformationum*, si dhe në *Testamenta notariae*, origjinën e familjes së Gazullit mund ta gjurmojmë që nga fillimi i shek. XIV në Raguzë e deri në fund të shek. XVI. Emri figuron në dokumentacionin e shkruar në shumë variante, si: Gazulus, Gasolo, Gazolus, Gazola, Gasolus, Gassolus, jo vetëm në alfabetin latin, por madje edhe në cirilik. Në këto forma e gjejmë edhe në burimet e botuara

⁷ Josephus Gelcich, "Monumenta Ragusina (Libri Reformationum)", *Monumenta Spectantia historiam slavorum meridionalium*, Volumen Vigessimum Nonum, Academia Scientiarum et Artium Slavorum Meridionalium, Tomus V, ann. 1301-1336 (Zagreb: Ex Officina Societatis Typographicae, 1897), 17, 25, 39, 424.

⁸ Për aktivitetet e shqiptarëve në Raguzë në gjuhën shqipe, shih Edmond Malaj, "Marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare ndërmjet Raguzës dhe trojeve arbërore", *Studime historike*, viti LXXV (LVIII), nr. 1-2 (2021): 7-36; për më shumë shih: Irmgard Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern während des Mittelalters. Randbemerkungen zur Problematik der balkanologischen Forschung", *Beiträge zur Südosteuropa-Forschung. Anlässlich des I. Internationalen Balkanologenkongresses in Sofia 26. VIII, 1.IX.1966. Arbeitskreis Südosteuropa-Forschung bei der Deutschen Forschungsgemeinschaft* (München: Trofenik, 1966), 339.

të Radoniqit,⁹ Stojanoviqit¹⁰ dhe në kadastrat e Shkodrës në vitet 1416-1417.¹¹ Në një dokument të Arkivit Shtetëror të Venecies, shumë anëtarë të familjes Gazulli përmenden si Gasolj: Bardh (*Bard Gazolj*), Klamadh (*Clamada Gasolj*) dhe Menkez (*Menchese Gasolj*).¹² Studiuesi çek i Mesjetës, Jireček, italiani Cordignano dhe hungarezi Banfi, bien dakord se familja Gazulli vjen nga Veriu i Shqipërisë, përkatësisht nga fshati Kukël në afërsi të Lezhës.¹³

Sipas të dhënave arkivore në *Libri Reformationes* të arkivave shtetërore të Dubrovnikut, emri i familjes Gazulli gjendet në Dubrovnik që nga vitet 1301-1336.¹⁴ Familja e Gjon Gazullit në Dubrovnik gjurmohet nga gjyshi i Gjonit, Pal Gazulli, i cili kishte ardhur nga fundi i shek. XIII. Ai kishte pasur dy djem: Mateun dhe Gjnin, dhe ishte pikërisht Gjini, babai i Gjonit, i cili shpesh përmendet edhe në dokumente bashkë me emrin e Gjonit, duke i çuar studiuesit në ngatërrimin e emrave të të dyve.¹⁵ Mate Gazulli, xhaxhai i Gjonit, ishte tashmë qytetar i Republikës së Raguzës në fillim të shek. XV dhe sipas

⁹ Jovan Radonić, “Đurađ Kastriot Skenderbeg i Arbanija u XV veku”, *Spomenik XCV*, Istoriska građa. Drugi razred, knj. LXXIV, Srpska Kraljevska Akademija (Beograd: SKA, 1942), 108.

¹⁰ Ljubomir Stojanović, *Stare srpske povelje i pisma*, Knjiga I-II (Beograd-Sremski Karlovci: SKA, 1934), 215.

¹¹ Injac Zamputi, *Regjistrimi i Kadastrës dhe i Koncesioneve për rrethin e Shkodrës 1416-1417* (Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, 1977), 97.

¹² Josephi Valentini S. J., *Acta Albaniae Veneta Saeculorum XIV et XV. Labore reperta et transcripta ac typis mandata. Pars Secunda. Saeculi XV parascanderbegianam periodum complectens*. Tomus Octavus. Ab anno MCDVII ad MCDIX (München: Rudolfo Trofeniko editore, 1970), 320 (nr. 2158/41); 347 (nr. 2158/76).

¹³ Konstantin Jireček, “Die Romanen in den Städten Dalmatiens während des Mittelalters”, *Denkschriften Österreichische Akademie der Wissenschaften*. Philosophisch-historische Klasse, vol. XLVIII, part III (Vjenë: In Commission bei C. Gerold's Sohn, 1904), 39; Fulvio Cordignano, *L'Albania a traverso l'opera e gli scritti di un grande Missionario italiano il P. Domenico Pasi, S.I. (1847-1914)* (Roma: Istituto per l'Europa Orientale, 1933); Banfi, “Ma i moçmi humanist”, 19.

¹⁴ J. Gelcich, “Monumenta Ragusina”, vol. XXIX, 1897, 9, 17, 25, 39, 424.

¹⁵ Gjoni, i biri i Gjnin Gazullit nga Arbëria (*Johannes Ginni Gaxuli de Albania*). Gaspare Zonta & Ioanne Brotto, *Acta Graduum Academicorum Gymnasii Patavini ab anno 1406 ad annum 1450 Cum aliis antiquioribus in Appendice additis indicio historico collecta ac digesta curantibus*. Editio Altera. III. Index Nominum. Istituto per la Storia dell'Università di Padova. (Padova: Editrice Antenore, 1970), 167, 294; Banfi, “Ma i moçmi humanist”, 21; Jahja Drançolli *keqkupton* emrin Gjon dhe e quan atë vazhdimisht Gjnin. Drançolli, *Gjin Gazulli*, 30 e vijim.

testamentit të regjistruar më 27 tetor 1427, ishte një ndër njerëzit e pasur të Dubrovnikut.¹⁶ Gjoni trashëgoi pjesën më të madhe të pasurisë së tij, megjithëse pjesë të mëdha trashëguan edhe nëna e tij, Sombola (Zymbyle apo Sumbulla?), vëllai i tij, Pali dhe motra e tij, Lucia.

Duke marrë parasysh faktin që një pjesë e mirë e pasurisë së Mate Gazullit u shpërnda edhe ndër shqiptarët e Tivarit, Danjës, Pultit, Ulqinit e madje edhe të vendeve të tjera,¹⁷ mund të dalim në konkluzionin se, të gjithë anëtarët e familjes së Gjon Gazullit si dhe shqiptarët e tjerë që përmenden në testament, ishin tashmë pjesë e njohjeve dhe e lidhjeve të familjes së Gazullorëve e rrjedhimisht në kontakt të drejtpërdrejtë apo të tërthortë edhe me vetë Gjonin. Pali dhe Ndreu, të cilët gjithashtu jetonin në Raguzë, ishin sigurisht pjesë e këtij rrjeti social dhe duke qenë se edhe ata ishin shpesh të angazhuar në aktivitete diplomatike, sidomos në luftën kundër osmanëve, është e qartë që e gjithë familja Gazulli kishte një pozicion elitare ndër shqiptarët e atjeshëm.

Rrjeti social me vendësit e Raguzës

Se kur ka lindur Gjon Gazulli është akoma një fakt i panjohur, dhe pikërisht mungesa e një informacioni të tillë është sipas studiuesit Tadić (Tadiç) dhe të tjerëve një argument i fortë që tregon se Gazulli nuk mund të ketë lindur në Raguzë, por është i ardhur në këtë qytet. Duke qenë se që nga shek. XIV, Republika e Raguzës kishte një ndër sistemet më të zhvilluara të regjistrimit të popullsisë, sidomos të lindjeve dhe të vdekjeve të qytetarëve të saj, ishte e pamundur që një bebe e lindur në Raguzë të shpëtonte pa u regjistruar po në ato ditë kur lindi.¹⁸ E megjithatë, edhe pse i ardhur, Gjon Gazulli u integrua aq mirë në jetën e Republikës së Raguzës, sa që besnikëria e tij ndaj saj, jo vetëm që nuk u vu kurrë në pikëpyetje, por përkundrazi, u vlerësua aq lart, sa që atij iu besuan disa nga detyrat më delikate dhe më të rëndësishme për jetën dhe mbarëvajtjen e kësaj Republike, siç do ta paraqesim në vijim.

¹⁶ “*Mateus Gaxuli, dicto pizolo,*” e shkroi testamentin e tij më 24 shtator 1426, i cili u regjistrua më 27 tetor 1427. Testamenti tani ruhet në *DAD, Testamenta Notariae XI*, fol. 161^v-162^v.

¹⁷ *Po aty*, fol. 161^v-162^v.

¹⁸ Tadić, “*Johannes Gazulus*”, 439; shih gjithashtu edhe Etleva Lala, “*Arkivat e Penitencierisë së Shenjtë Apostolike dhe një rast aborti në Pultin e Poshtëm*”, revista *Kosova*, 47 (2022), 21-50.

Nuk dimë shumë për jetën e Gazullit në Dubrovnik para se të shkonte për të studiuar në Padova, por mendohet që Antun Vuceta mund të ketë qenë mësuesi i Gjonit gjatë kohës që ishte në Dubrovnik. Arsyeja për këtë hamendësim është përmendja e tij në një mënyrë të veçantë në testamentin e xhaxhait të Gjonit, Mate Gazullit, i cili e quan atë “*mio filiol spiritual*”,¹⁹ si dhe fakti që në një autorizim noterial të datës 2 qershor 1428 mjeshtër Gjoni, i biri i Gjin Gazullit (*magister Johannes quondam Ghini de Gaxoli, de Ragusio*), deklaroi se gjatë studimeve të tij në Padova ka lënë një arkë të mbushur me libra, dhe me gjëra të tjera, mes të cilave edhe një bllok shënimesh të nxjerrë prej librave. Gjoni autorizon pikërisht Antun Vucetën nga Ragusa që të kujdesej për këta libra.²⁰

Pas diplomimit në Padova, më 31 janar 1430,²¹ Gazulli u kthye në Dubrovnik, dhe pati kontakte me studiues të mëdhenj, si Filip de Diversis, një profesor i Liceut raguzan në vitet 1434-1440, njëkohësisht edhe historian i famshëm i kohës së tij. Po kështu, ai mbajti kontakte të rregullta me disa doktorë të mjekësisë me origjinë italiane dhe me një doktor me origjinë shqiptarë.²²

Ka mendime të ndryshme, nëse Gazulli ishte dominikan apo jo. Appendini²³ dhe Agić-i mendojnë që ishte murg dominikan, por Banfi,²⁴

¹⁹ DAD, *Testamenta Notariae XI*, fol. 161v-162v.

²⁰ DAD, *Diversa Notariae XV*, fol. 225v.

²¹ “31 gennaio: examen et publica in artium magister presbiteri Joannis Gini Gaxuli de Albania. Antonius Zeno de Mediolano, vic. Perart et med. Doct. Mag. Anthonium Cermesonum quod Cermesoni de Padua, Ugonem f.q. Andree de Benziis de Senis, Stephanum de Doctoribus et Zigismundum de Polcastris de Padua, presentato coram nobis, presbiteri Johanne ad subeundum privatum examen, examinari fecimus et qui fuit approbatus in aula supra viridarium episcopatus paduani fecimus doctorem in plena contione prefatorum et Marci de Osnago art. Doct. Et med. Padue studentis rect. Artistarum per Antonium Cermesonum insignitus presentibus frater Andrea de Durachio, ord min. Sacre pagine bacalarario, fr. Simone Marini Ptigith de Raguseo, d. Presbitero Georgio quodam Gini Gaparsi de Albania canonico ecclesie cathedralis Durachii, fr. Matheo Radogosti de Ragusio, Theodorico quodam Petrucii de Spilimbergo art. Doctore, Petro de Firmo art. Parito.” Zonta & Brotto, *Acta Graduum*, 167; Banfi, “Ma i moçmi humanist”, 21; Drançolli, *Gjin Gazulli*, 30.

²² Tadić, “Johannes Gazulus”, 439.

²³ Appendini, *Notizie storico-critiche*, 41; “Anche il P. Cerva ci parla brevemente del Gazoli dicendoci, che fioriva nel secolo XV, insigne per dottrina, e maestro in sacra teologia. Ma privo di altre notizie egli si augura, che a quelcheduno riesca di rinvenire qualche documento atto ad illustrare la memoria di un uomo, di cui nei

argumenton se nëse do të kishte qenë dominikan, emri i tij do të ishte shkruar tashmë në *Monumenta Congregationis S. Dominici de Ragusio Ordinis Fratrum Praedicatorum*, që përmban të gjithë emrat e dominikanëve raguzanë të të gjitha kohërave, gjë që nuk ka ndodhur.²⁵ Appendini dhe Agić-i e quanin atë *presbyter*, dhe Drançolli po kështu e konsideron atë prift.²⁶

Besnikëria e Gazullit ndaj Republikës së Raguzës, do të shihet qartë në favoret dhe privilegjet që Gazulli i siguron Senatit të Raguzës, nga kontaktet e tij personale me pushtetet më të larta të kohës së tij, një prej të cilave pa dyshim ishte edhe lidhja personale që Gazulli kishte me Mbretin e Hungarisë, Zigismundin e Luksemburgut, i cili me ndihmën e Gazullit bëhet perandor i Perandorisë së Shenjtë Romake të popullit gjerman, siç quhej zyrtarisht në atë kohë e gjithë Europa Perëndimore.

Rrjeti social me diplomatët dhe autoritetet e kohës

Pasi kreu studimet në Padova, Gazulli u angazhua menjëherë me misionet në Itali në vitet 1432-1433. Sipas një dokumenti të datës 26.03.1432, Senati raguzan e dërgoi Gazullin në Romë (*egregio artium doctori magistro presbitero*), me qëllim që të vihej në kontakt me Mbretin hungarez, Zigismundin e Luksemburgut, i cili kishte shkuar në Romë për të marrë kurorën perandorake nga Papë Eugjeni IV.²⁷ Misioni i

pubblici, e privati archivi trova fatta menzione, segnantemente nel 1459. Dalla lettera apparirà, quanto grande astronomo, e matematico sia stato il Gazoli."

²⁴ Banfi, "Ma i moçmi humanist", 20.

²⁵ Kjo vepër nuk është botuar kurrë, por sipas Banfit ruhet në Arkivin Qendror të Urdhrit të Dominikanëve në Koncilin e Santa Sabinës në Romë. Banfi, "Ma i moçmi humanist", 20.

²⁶ Drançolli, *Gjin Gazulli*, 29.

²⁷ *DAD, Lettere et commissiones Levantis XI*, fol. 82v-83v; Jovan Radonić, *Acta et diplomata Ragusina. Fontes rerum Slavorum Meridionalium (Dubrovačka akta i povelje. Izvori za istoriju južnih slavena)*. Series Prima. Tomus I, fasciculus 2. (Ureduje, sabrao i objavio, Jovan Radonić. Serija prva, knjiga I, sveska 2. Srpska Kraljevska Akademija. Zbornik za Istoriju, jezik i književnost srpskog naroda. Treće odeljenje, knjiga III. (Beograd: SKA, 1934), 329 (më tej: Radonić, *Dubrovačka akta*, I.); Ivan Božić, "Dubrovnik i Turska u XIV. i XV. veku", *Posebna izdanja, CC. Srpska Akademija Nauka. Istoriski Institut. Knj. III* (Beograd: Naučna knjiga, 1952), 58; Giuseppe Gelcich, Ludevít Thallöczy, *Raguza és Magyaroszág. Összekötetéseinek Oklevéltára. A Raguzai állami, a Bécsi Cs. És Kir. Titkos és egyéb Levéltárakban levő okiratokból (Diplomatarium Relationum Reipublicae Ragusanae*

Gazullit ishte që të ndërmjetësonte te Papë Eugjeni IV që Zigismundi i Luksemburgut të merrte kurorën perandorake sa më shpejt. Në këmbim të këtij nderi, Gazulli do të kishte gjithashtu një favor nga perandori i ardhshëm Zigismund: pasi të bëhej zyrtarisht perandor, ky i fundit do të ndërmjetësonte te Papë Eugjeni IV që ai t'i jepte Republikës së Raguzës licencën (që quhej privilegj) për të bërë tregti detare me jo-të-krishterët, ashtu siç ua kishte dhënë atë edhe Republikës së Venedikut dhe asaj të Gjenovës, gjë që i kishte shndërruar ato në një superfuqi detare.²⁸ Privilegji për të lejuar tregtinë detare me jokatolikët, ishte një licencë me rëndësi vitale për tregtinë dhe ekonominë e Dubrovnikut në shek. XV, pasi tregtia në det ishte gjëja kryesore nga e cila varej mirëqenia e gjithë Republikës së Raguzës. Pa dalje në det, Republika e Raguzës ishte e destinuar të mbetej vetëm një port i vogël.

Gjatë këtij misioni kaq vital për Republikën e Raguzës, Gazulli mori shumë letra nga Senati raguzan, ku theksohej vazhdimisht se sa e rëndësishme ishte për Republikën e Raguzës marrja e privilegjit.²⁹ Për këtë arsye, Gazullit iu desh të qëndronte për shumë kohë pranë Zigismundit dhe shpurës së tij mbretërore, e cila më vonë ishte edhe shpura e perandorit të ardhshëm Zigismund: fillimisht nga 11 korriku deri më 31 korrik të vitit 1432, por ngaqë Zigismundi nuk e pati të lehtë ta merrte kurorën perandorake, dhe madje as të takohej me Papë Eugjenin IV, atyre iu desh të qëndronin atje për gati një vit të tërë, herë në Romë e herë në Siena. Kjo vonesë e marrjes së kurorës perandorake, dhe ngulmimi i Mbretit Zigismund për ta marrë atë me çdo kusht, e bënë rolin e Gjon Gazullit shumë më të rëndësishëm dhe vendimtar në këtë pritje të gjatë.

Në nëntor të vitit 1432, Zigismundi ishte akoma në Romë dhe sigurisht që edhe Gazulli ishte me të. Lidhja e ngushtë me shpurën mbretërore dhe perandorake vërehet më tej në autoritetin e padiskutueshëm të Gazullit, kudo që ndodhej, sidomos në

cum Regno Hungariae). (Budapest: Kiadaja a M. Tud. Akadémia Tört. Bizottsága, 1887), 568 (më tej: Gelcich, Thalloczy, *Diplomatarium*).

²⁸ Banfi, "Ma i moçmi humanist", 22.

²⁹ ... *venerabilem presbiterum Johannem Gasulum [...] quem litteris nostris credentialibus et alii multo iam tempore pro navigatione mercatorum nostrorum ad infidelium partes et alii obtinendis a Summo Pontifice suo loco et tempore ad Serenitatem Vestram destinavimus, eundem pro praedictis obtinendis humiliter supplicando comendamus [...]*. Gelcich, Thalloczy, *Diplomatarium*, 371.

ndërgjegjësimin e Selisë së Shenjtë dhe të fuqive perëndimore për rrezikun osman.

Përveç letrave të shumta, Senati raguzan i dërgon edhe tre diplomatë Gjon Gazullit, i cili quhej tashmë “ambasadori ynë pranë Madhërisë së Tij” (*maestro Giovanni Gaxolo nostro nunzio presso Sua Maesta*).³⁰ Më 14 nëntor 1433, ata (Ser Pietrus de Prodanello, Jacomo dhe Giovanni de Cotruglio) i sollën Perandorit të ri të sapokurorëzuar Zigismund, një dhuratë prej 4 000 dukatesh ari. Edhe Zigismundi u tregua besnik ndaj Gazullit dhe raguzanëve: vërtet privilegjin për Republikën e Raguzës nuk arriti ta merrte ditën që u kurorëzua perandor, por disa muaj më vonë në Koncilin e Bazelit më 15.03.1434, arriti të negocionte me sukses për Republikën e Raguzës, duke mundësuar kështu marrjen e licencës së shumëpritur të lundrimit dhe të tregtisë së lirë në zonat e pushtuara nga osmanët, gjë që e ngriti Raguzën në rangun e një superfuqie detare.

Për sa i përket këtij roli diplomatik të Gazullit, kemi nëntë dokumente të ruajtura, pesë prej të cilave gjenden në serinë: *Letterae et commissiones Levantis* dhe katër në serinë: *Acta Consilii Rogatorum* të Arkivit Shtetëror të Dubrovnikut. Nga këto dokumente është lehtësisht e verifikueshme që Gazulli gëzonte respektin dhe autoritetin më të lartë në Republikën e Raguzës. Aktiviteti i suksesshëm diplomatik i Gazullit e bëri pa dyshim Republikën e Raguzës të shndërrohej në një prej republikave më të fuqishme të kohës, si për sa i përket pushtetit tregtar dhe ekonomik, ashtu edhe atij politik dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare.

Një vit pas marrjes së privilegjit të lundrimit të lirë në dete dhe të tregtisë në të gjithë botën detare për Raguzën e asaj kohe, një tjetër sukses i Gazullit ishte edhe misioni i tij diplomatik në Italinë e Jugut.³¹ Ky territor ishte vazhdimisht burim trazirash për tregtarët raguzanë për shkak të piratëve, sidomos kur donin të kalonin nga deti Adriatik në atë Jon e Mesdhe. Kjo pjesë ishte e kontrolluar nga Mbretëria e Napolit në

³⁰ DAD, Lettere et commissiones Levantis XI, fol. 120^v-122^r; Gelcich, Thalloszy, *Diplomatarium*, 376, 382: *Iterata suprascripta littera die 14 novembris, hoc mutato sive addito, quod per latorem ipsarum literarum cum magistro Johanne Gaxulo, nuntio nostro penes Maiestatem Suam existente, ei in eius praesentia fiet solutio dictorum 4.000 ducatorum...*

³¹ DAD, *Acta Concilii rogatorum V*, fol. 244^v-247^v; Radonić, *Dubrovačka akta I-1*, 249.

atë kohë, kështu që Gazulli u nis më 10 mars të vitit 1435³² për të takuar princin e Tarantos e për ta zgjidhur edhe këtë çështje mjaft të rëndësishme për Republikën e Raguzës. Gazulli qëndroi për rreth dy muaj në këtë zonë, dhe puna e tij u kurorëzua sakaq me rezultate të dukshme: 60 raguzanë u vendosën menjëherë në Mbretërinë e Napolit, me qëllim që të krijohej një bazë garantuese për marrëdhënie harmonie afatgjatë me banorët e kësaj mbretërie.³³

Pas misionit të suksesshëm në Italinë e Jugut, Gazulli u kthye në Raguzë, për të marrë një tjetër mision të rëndësishëm, këtë radhë në oborrin e princit të Slavonisë, Matej Tallovec,³⁴ i cili ishte kurorëzuar kohët e fundit nga Zigismundi. Me të Gazulli ishte njohur gjatë kohës së qëndrimit në Itali, në shpurën e mbretit dhe më pas Perandorit Zigismund.³⁵ Letra e princit Matej drejtuar Senatit raguzan që daton nga 11 janari 1436, e mori përgjigjen më 29 shkurt të po atij viti.

Gjergj Kastrioti-Skënderbeu numërohet gjithashtu si një ndër misionet më të suksesshme të Gjon Gazullit, sepse ishte pikërisht Gazulli ai që e bëri aktual rrezikun osman në Selinë e Shenjtë gjatë kohës kur ishte në oborrin perandorak të Zigismundit në vitet 1433-1434, duke i kthyer sytë e Selisë së Shenjtë dhe madje të të gjithë Europës ndaj një rreziku që pak kuptohej si i tillë deri në atë kohë. Po ashtu, Gazulli mundësoi komunikimin midis Selisë së Shenjtë dhe Republikës së Raguzës për të ndihmuar Skënderbeun, siç ndodhi edhe në Vitin Jubilar ose Vitin e Shenjtë 1450, kur Gazulli i kërkoi Selisë së Shenjtë që gjatë këtij viti 1450-1451 të mobilizojë gjithë Perëndimi për ta ndihmuar financiarisht Skënderbeun në luftën kundër osmanëve. Letra me titull

³² *DAD, Acta Concilii rogatorum V*, fol.244^v-247^v; *Lettere et commissiones Levantis XI* (15. 03. 1435).

³³ *Ne abbiamo un legittimo monumento nel grande Archivio della Regia Camera di aver ripopo- lato tra gli altri paesi, Cajlelluccio de' Sauri in Capitanata, avendo il Re Ferdinando concesso quel paese ad uo tale Albanese, per nome Giovanni de Gazuli, il quale vi portò dapprima 60 Schiavoni, o Greci per riabitario, e così anche è a dirsi, che ripopolato vesserò Campomarino, Ururi, Portocannone ect.* Lorenzo Giustiniani, *Dizionario geografico ragionato del Regno di Napoli di Lorenzo Giustiniani*, A sua Maesta Ferdinando IV, Re delle Due Sicilie, Tom. I, bleni X (Napoli: 1805), 193.

³⁴ *DAD, Lettere et commissiones Levantis XII*, fol. 16^r; Tadić, "Johannes Gazulus", 439-440.

³⁵ *DAD, Lettere et commissiones Levantis XI*, fol. 82r-83v; *Acta Consilii Rogatorum V*, fol. 7^f, 99^f, 115^v; Radonić, *Dubrovačka akta, I-1*, 329; Gelcich, *Thalloszy, Diplomatarium*, 368.

Commissio data magistro Johanni de Gazulo oratori misso ad Summum Pontificem, e lëshuar në Raguzë më 27 shkurt 1451, është sjellë për herë të parë në shqip nga Florio Banfi në vitin 1932, dhe u botua në revistën “Leka”.³⁶

Sigurisht që Republika e Raguzës e përdori në favorin e vet reputacionin dhe aftësitë diplomatike të Gazullit, duke i kërkuar atij të ndërmjetësoje te Selia e Shenjtë për heqjen e taksave ndaj Raguzës përgjatë Vitit Jubilar 1451, të ardhura këto që do të përdreshin për të ndihmuar Skënderbeun në fushatën e tij kundër osmanëve. Në këtë letër, Gazulli e vë theksin në marrëdhëniet shumë të mira të Republikës së Raguzës me Skënderbeun dhe te harmonia midis tyre në luftën kundër osmanëve. Që kjo harmoni nuk ishte e vetëkuptueshme, kjo u duk qartë pas vdekjes së Gazullit në vitin 1465, kur Skënderbeu jo vetëm që nuk mori ndihma të tjera, por as nuk u prit më fare nga Senati i Raguzës.³⁷

Nëse Skënderbeu nuk do të kishte pasur ndërmjetësimin e Gjon Gazullit për ta përkthyer kauzën e tij në një gjuhë të kuptueshme për Selinë e Shenjtë dhe Perëndimin, lufta e tij do të kishte mbetur ndoshta krejt e panjohur në Perëndim dhe, sigurisht, nuk do të kishte marrë asnjë lloj përkrahjeje papnore. Gjon Gazulli, jo vetëm që luajti një rol të rëndësishëm në Selinë e Shenjtë për sa i përket përkrahjes së luftës antiosmane të Skënderbeut, por edhe me kontaktet që ai i kishte mundësuar Skënderbeut me Hungarinë, Raguzën, me Perandorin Zigismund dhe mbarë Gadishullin Apenin e më gjerë.

Pas vdekjes së Gjon Gazullit në vitin 1465, lufta e Skënderbeut filloi të zbehej gjithmonë e më shumë në sytë e Selisë së Shenjtë dhe të

³⁶ Banfi, “Ma i moçmi humanist shqiptar”, nr. 1-2, 31-33. Originali i këtij dokumenti gjendet në DAD, *Lettere et Commissiones Levantis XI (1448-1451)*, fol. 63^v-55^r; Gelcich, Thalloszy, *Diplomatarium*, 481-87.

³⁷ Aurel Plasari, *Skënderbeu: Një histori politike* (Tiranë: Instituti i Studimeve Shqiptare “Gjergj Fishta”, 2020), 697, shënimi 1: Këshilli i Pregadëve, më 2 nëntor 1466, për pritjen e Skënderbeut: “*Ser Nicola Mar. De Gondola, Ser Aloysius de Georgio, Ser Helias Pe. De Bona, electi ad eundum obviam domino Schanderbegh.*” (Citimet në vijim janë sipas A. Plasarit, 697, shënimi 1: “*Diplomatarium Rag., 774 (DAD), Djuradj Kastriot, nr. 337; po ai, po atë datë, për të njëjtën çështje: “Prima pars est de dando libertatem domino Rectori et suo Minori Consilio faciendi tres ex nobilibus nostris, qui vadant ad obviam domino Schanderbegh et eum rogent quod non veniat Ragusium ob bonum respectum [...]. Prima pars est de dimittendo quod fusta Schanderbegi intret catenas portus.” Diplomatarium Rag., 780 (DAD). Djuradj Kastriot, nr. 338.*”

Perëndimit, duke bërë që edhe marrëdhëniet e Skënderbeut me Selinë e Shenjtë të ftoheshin. Kauza e Skënderbeut u tjetërsua nga intrigat oborrtare të venecianëve, gjë që çoi në humbjen e vëmendjes dhe të dashamirësisë që kishte pasur deri atëherë Skënderbeu në sytë e Selisë së Shenjtë. Ky është një tjetër fakt, i cili provon se Gazulli kishte qenë vërtet luani diplomatik që qëndronte pas Skënderbeut dhe që me reputacionin e autoritetin e tij ua kishte mbyllur derën të gjitha intrigave, thashethemeve e planeve keqdashëse kundër Skënderbeut në sferat e larta, duke bërë që Skënderbeu të shkëlqente jo vetëm në terren, por edhe në diplomacinë e Perëndimit të asaj kohe. Kjo tregon edhe një herë se sa i fuqishëm ishte Gjon Gazulli në krijimin dhe menaxhimin e rrjeteve që kishte krijuar.

Rrjeti social me botën intelektuale

Gjoni, i biri i Gjini Gazullit nga Arbëria (*Johannes Ginni Gaxuli de Albania*)³⁸ i kreu studimet e tij në Universitetin e Padovës, ku u diplomua në vitin 1428 në teologji dhe në filozofi. Gjatë kësaj kohe, departamenti i matematikës drejtohej nga profesor Prosdocius de Beldomandis (1422-1428) dhe në të kishte edhe profesorë të tjerë si ai i mjekësisë, Antonius Cermesoni, dhe i astrologjisë, Hugo Benci.³⁹ Gazulli e mbrojti doktoratën e tij në filozofi dhe teologji para profesorëve Stephanus de Doctoribus dhe Zigismundus de Pol Castris më 31 janar 1430.⁴⁰ Në vitet 1436-1445, Gazulli është tashmë profesor i matematikës në Padova, në vend të prof.

³⁸ Zonta, Brotto, *Acta Graduum*, 167, 294; Banfi, “Ma i moçmi humanist”, 21.

³⁹ Banfi, “Ma i moçmi humanist”, 21; shih edhe Antonio Favaro-n, “I lettori di matematiche nelle Università di Padova”, *Memorie e Documenti per la Storia dell’Università di Padova*, vëll. I (Padova: La Garangola, 1922), 30.

⁴⁰ “31 gennaio: examen et publica in artium magister presbiteri Joannis Gini Gaxuli de Albania. Antonius Zeno de Mediolano, vic. Perart et med. Doct. Mag. Anthonium Cermesonum quod Cermesoni de Padua, Ugonem f.q. Andree de Benziis de Senis, Stephanum de Doctoribus et Zigismundum de Polcastris de Padua, presentato coram nobis, presbiteri Johanne ad subeundum privatum examen, examinari fecimus et qui fuit approbatus in aula supra viridarium episcopatus paduani fecimus doctorem in plena contione prefatorum et Marci de Osnago art. Doct. Et med. Padue studentis rect. Artistarum per Antonium Cermesonum insignitus presentibus frater Andrea de Durachio, ord min. Sacre pagine bacalario, fr. Simone Marini Ptigith de Raguseo, d. Presbitero Georgio quodam Gini Gaparsi de Albania canonico ecclesie cathedralis Durachii, fr. Matheo Radogosti de Ragusio, Theodorico quodam Petrucii de Spilimbergo art. Doctore, Petro de Firmo art. Parito;” Zonta, Brotto, *Acta Graduum*, 167; Banfi, “Ma i moçmi humanist”, 21; Drançolli, *Gjin Gazulli*, 30.

P. Beldomandi, i cili kishte ndërruar jetë. Lëndën e matematikës, Gazulli e dha deri në vitin 1439.⁴¹

Sapo Matias Korvini erdhi në fuqi si mbret i Mbretërisë së Hungarisë, madje pa u kurorëzuar akoma si mbret, e ftoi menjëherë Gjon Gazullin të vinte në shërbim të tij në oborrin e tij mbretëror. Sigurisht që kjo nuk ndodh pa pasur një njohje paraprake të punës dhe të veprës së Gazullit, për të cilën, me sa duket, Matias Korvini ishte informuar me superlativa nga shpura e tij mbretërore që e njihnte mirë punën dhe influencën e Gazullit. Kujtojmë këtu që ata ishin e njëjta shpurë e cila kishte marrë pjesë në suksesin e Zigismundit në Selinë e Shenjtë. Po kështu, reputacioni i Gazullit për zbulimin e tij astronomik daton, sipas studiuesve të asaj kohe,⁴² nga viti 1438, kohë kjo kur Gazulli ishte tashmë profesor në Padova. Edhe Stipčevići shkruan se Gazulli e shkroi veprën me titull: *De directionibus* pikërisht në vitin 1438,⁴³ bashkë me atë që ndodhet tashmë në dorëshkrim: *De astrologiae utilitatae*,⁴⁴ e që vazhdon të ruhet në Arkivin Shtetëror të Dubrovnikut.

⁴¹ “19 august 1439. *Licentia privati examinis et publica doctoratus in Jus Canonicus D. Presbiteri Bonini Alegreti de Corzula cath. Eccl. Eiusdem loci ... Paduae in ep. pal. Presentibus... Johanne de Ragusio art. Doctore,*” Zonta, Brotto, *Acta Graduum*, 294; Banfi, “Ma i moçmi humanist”, 22.

⁴² Franciscus Iunctino Florentismo, *Speculum astrologiae quod attinet ad Iudiciariam rationem nativitatum atque annuarum reuolutionum: cum nonnullis approbatis Astrologorum sententiis* (Lugundi: Sumptibus Philippi Tinghi Florentini, Cum Privilegio Regio, 1573), 15; Francisco Iunctino & Francisco Valesii, *Speculum Astrologiae universam Mathematicam scientiam, in certas classes digestam*. Tomus Prior. (Lugundi: In Officina Q. Phil. Tinghi Florentini: Apud Simphorianum Beraud. Cum Privileg. Caes. Maiest. et Reg. Christian, 1581), 24; Ioanne Baptista Riccolus, *Almagestum novum astronomiam veteram novamque complectens observationibus aliorum et propriis* (Bologna: Ex Typographia Haeredis Victorij Benatij, 1651); Ioanne Baptista Riccolus, *Almagestum novum astronomiam veteram novamque complectens observationibus aliorum et propriis*. Nouisque Theorematis, Problematis ac Tabulis promotam, in tres tomos distributam quorum argumentum (Bononiae: Ex Typographia Haeredis Victorij Benatij, 1651); “*Joannes Gazulus Ragusinus, Astrologus magni nomini fuit Anno 1438.*”

⁴³ Aleksander Stipčević, *Socijalna povijest knjige u Hrvata*, Knjiga I, Srednji vijek (Zagreb: Skolska Knjiga, 2004), 244.

⁴⁴ *Po aty*, 342; Grmek & Dadić, “O astronomu Ginu Gazulu”, 53-94; Žarko Dadić, *Egzaktne znanosti hrvatskoga srednjovjekovlja* (Zagreb: Globus, 1991), 121-130.

Duke qenë se Mbreti Matias Korvini kishte një interes të jashtëzakonshëm për astrologjinë,⁴⁵ si shkencë që merret me parashikimin e së ardhmes, duket që Gjon Gazulli nuk ishte shumë entuziast për të pranuar një përgjegjësi të tillë. Gjon Gazulli e konsideronte veten astronom, dhe i tillë ishte, sepse merrej me astronominë si shkencë dhe jo me parashikimin e së ardhmes. Në atë kohë nuk kishte një ndarje të prerë midis astronomisë dhe astrologjisë,⁴⁶ kështu që nuk ekzistonte as terminologjia e duhur për t'ua sqaruar të tjerëve, aq më tepër një mbreti. Gazulli nuk pranoi të shkonte në oborrin e Mbretit Korvin, duke nxjerrë si justifikim shëndetin e tij të dobët në atë kohë dhe moshën e shtyrë.⁴⁷ Megjithatë, ai dërgoi dorëshkrimin apo dorëshkrimet e veta me zbulimin e tij astronomik, gjë që e dëshmon letra e Jan Çesmiçkit (Pannonius):

Jo vetëm që keni përbushur lehtësisht pritshmëritë tona ndaj jush, por i keni tejkaluar shumë ato. Ne jemi shumë të kënaqur me librin tuaj, që na e dërguat së fundmi. Ai ishte i mbushur me aq shumë dije, me aq shumë elokuencë, saqë ishte kënaqësi e madhe për ta lexuar dhe shumë i dobishëm për ta studiuar. Në librin tuaj ne kemi gjetur përgjigje për disa mendime të paqarta të astrologëve të lashtë, të cilat nuk mund t'i kuptonim qartë. Prandaj ju nxisim që të vazhdoni me zell të përfundoni së shkruari atë që keni filluar, sepse është shumë i rëndësishëm për studiuesit dhe për reputacionin tuaj, duke përbushur edhe dëshirën tonë. Për më tepër, ju lutemi që të na jepni më shumë informacion për “shtëpitë” e Ptolemeut dhe instrumentet e tjera që përmendni në punën tuaj. Ju mund t’i përgatisni ato atje, me shpenzimet tona, pasi këtu në Mbretërinë e Hungarisë ne nuk kemi artizanë të aftë që të mund të bëjnë këto gjëra. Për çdo lloj shpenzimi, në qytetin tuaj ose në ndonjë vend tjetër më të përshtatshëm për ju, do të përgjigjemi ne plotësisht.⁴⁸

⁴⁵ Darin Hayton, “Expertise *ex Stellis*: Comets, Horoscopes, and Politics in Renaissance Hungary”, *Osiris*, History of Science Society, vëll. XXV, nr. 1 (Chicago: Chicago Pres, 2010), 29.

⁴⁶ Po aty, 30.

⁴⁷ Grmek & Dadič, “O astronomu Ginu Gazulu”, 57-60.

⁴⁸ “*Ioannes Episcopus Quinque-Ecclesiensis ad Ioannem Gazulo Ragusinum. — Conceptam dudum de vobis expectationem nostram rei ipsius experientia non modo facile implevit, verum etiam longe superavit. Vehementer siquidem nobis placuit liber ille vester, quem nuper ad nos misistis. Tanta is doctrina, tanta eloquentia refertus*

Korvini i apasionuar pas astrologjisë kishte sjellë në oborrin e tij jo vetëm dorëshkrimet e Gazullit dhe ndoshta edhe astrolabin e krijuar prej tij, siç sugjeron letra e Panonius-it, por edhe shumë vepra të astrologëve të asaj kohe, duke krijuar të ashtuquajturën *Bibliotheca Corviniana*,⁴⁹ një ndër bibliotekat më të pasura të asaj kohe. Sigurisht që manuskriptet dhe librat nuk do të kishin shumë vlerë pa specialistët që t'i përdornin ato, kështu që oborri i Korvinit u shndërrua në një oaz studiuesish, ku u mblodhën astrologët/astronomët e studiuesit më të famshëm të kohës. Ndër ta ishin edhe Johannes Müller, *alias* Regiomontanus⁵⁰ dhe Martin Bylica, të cilët ishin takuar dhe miqësuar në Romë. Erdhën në oborrin e Korvinit që të jepnin matematikë dhe astronomi në *Academia Istropolitana* që do të hapej në vitin 1465, por meqenëse universiteti nuk u hap atë vit, Regiomontanus-i dhe Bylica përfunduan në pallatin e Vitézit në Esztergom. Aty Johannes Vitéz-i studioi në bibliotekën e famshme *Corviniana*, të cilën e drejtonte daja i tij, Jan Pannonius-i (Jan Çesmiçki). Ky i fundit i kishte shkruar në emër të oborrit mbretëror, të Mbretit Matias, një letër konfirmuese dhe shumë lavdëruese për punën e Gazullit, të cilin e kishte informuar se kishte marrë dorëshkrimet e tij.

Gjatë dy vjetëve që qëndruan në pallatin e Johannes Vitéz-it, Regiomontanus-i dhe Bylica shkruan shumë traktate astrologjike, me

apparuit, ut adeo legenti jucundum, et discenti se praestiterit fructuosum. Nam fatemur, scrupulosas quasdam veterum astrologorum sententias, quas jampridem clarius intelligere desiderabamus, ibidem nobis fuisse luculenter explicatas. Quamobrem serio vos hortamur, ut pergere in scribendo, ac coepta opera in finem prosequi velitis, pariter et studiosorum utilitati et vestrae gloriae, et voto nostro satisfacturi. Caeterum rogamus vos, ut armillas Ptolemaei, et alia instrumenta, de quibus in opere vestro mentionem facitis, nobis ad expensas nostras istic apud vos paranda et conficienda procuretis: quoniam hic in regno Hungariae scitos harum rerum artifices nullos habemus. Quidquid autem fuerit impensum, curabimus vobis in hac ipsa civitate vestra, vel alio loco opportuno, plene et efficaciter responderi.” Janus Pannonius, *Opuscularum. In qua exhibentur pauca quaedam e Plutarcho et Demosthene in Latinum eodem interprete translata, nec non orationes ejus et epistolae*. Pars altera (Traiecto ad Rhenum /Utreht/: Apud Bathol. Wild. Bibliop., 1784), 101; shih edhe Grmek & Dadič, “O astronomu Ginu Gazulu”, 59.

⁴⁹ Csaba Csapodi - Klára Csapodiné Gárdonyi, Tibor Szántó, *Bibliotheca Corviniana: The Library of King Matthias Corvinus of Hungary*, përktheu Zsuzsana Horn (New York: Frederik Praeger, 1969), 372-373.

⁵⁰ Ernst Zinner, *Leben und Werken des Johannes Müller von Königsberg gennant Regiomontanus* (Osnabrück: O. Zeller, 1968), 125.

siguri të frymëzuar nga pasuria e bibliotekës së Korvinit.⁵¹ Regiomontanus-i e përmend veprën e Gazullit në veprën e tij, gjë që është një provë e qartë se ai, jo vetëm që e ka pasur në dorë veprën e Gazullit, por edhe e kishte studiuar atë me themel duke u përpjekur ta kundërshtonte atë. Ai shkruan:

Gjon Gazulli nga Raguza, në kohën tonë edhe pse mori mësimë nga më i dituri Ptoleme, nga të saktët Gabë dhe shumë të tjerë, nuk solli absolutisht asnjë lehtësi në të kuptuarit e drejtimeve dhe krahasimit të shtëpive astrologjike, por përkundrazi me argumentet e tij, krijoi akoma më shumë kaos.⁵²

⁵¹ Ata shkruan traktatin astrologjik *Tabulae Directionum Profectionumque* dhe bashkëpunuan në një sërë tekstesh teknike astrologjike. Hayton, "Expertise *ex Stellis*", 33; Regiomontanus-i shkroi edhe *Tabulae ac Problemata Primi Mobilis* and his *Tabula Sinuum*, si dhe komentoit kopjet e Bylicës. Regiomontanus, "Tabula ac Problemata Primi Mobilis," BJ cod. 597 DD II 59; Regiomontanus, "Tabula Sinuum," BJ cod. 574. Shumë nga veprat e Regiomontanus-it u bënë pjesë e bibliotekës *Corviniana*, përfshi edhe *Tabulae Directionum et Profectionum*, që ishte hartuar me ndihmën e Martin Bylicës, si dhe veprat e tjera *Tabulae Primi Mobilis*, *Tabulam Primi Mobilis*, *Epitome "Almagesti"*, *Ephemerides* për vitet 1475-1506, *Defensio Theonis contra Trapezuntium* dhe dy tekstet e tij për instrumentet astrologjike: *De usu astrolabii Armillariorum* and *Super Torqueto Astronomico*. Csapodi & Csapodi-Gárdonyi, *Bibliotheca Corviniana*, 343-346; Hayton, "Expertise *ex Stellis*", 31; Po kështu, në këtë koleksion bënin pjesë edhe veprat e George Peurbach-ut, *Theoricae Novae Planetarum* dhe traktatet e tij për instrumentet: *Canones pro Compositione et Usu Gnomonis Geometrici*. Ata u bënë kundërshtarë të rreptë të teorisë së Gerard Cremona-s, *Theoretica Planetarum*, kundër së cilës Regiomontanus-i shkroi *Dialogus inter Viennensem et Cracoviensem adversus Gerardum Cremonensem in Planetarum Theoricis Deliramenta*. Claudia Kren, "Planetary Latitudes, the *Theoretica Gerardi* and Regiomontanus," *Isis*, vol. LXVII, nr. 2, A Journal of the History of Science Society. History of Science Society (Chicago: The University of Chicago Press 1977): 194-205; Për problemin e identifikuar nga Regiomontanus-i, shih Noel M. Swerdlow, "Regiomontanus on the Critical Problems of Astronomy", *Nature, Experiment and the Sciences: Essays on Galileo and the History of Sciences*. Boston Studies in the Philosophy and History of Science, vol. CXX (Boston: Springer, Dordrecht, 1990), 165-195; Hayton, "Expertise *ex Stellis*", 33.

⁵² F. Banfi, Regiomontanus, *Tabulae directionum* (shkruar më 1468, botuar më 1475): *Joannes Gazzulus Ragusinus nostra aetate tametsi Ptolomaei erudissimi, Gabusorum acutissimi, ac aliorum plurimum doctrinas acceperit, nullam tamen prorsus numerandi facilitate in directionibus ac aequandis domibus advexit, quin imo turbam maximam multitudine argumentorum concitavit.*

Nëpërmjet këtij citati, Regiomontanus-i lë shprehimisht të kuptohet që nga Gazulli ai kishte marrë jo vetëm dorëshkrimin origjinal të Gazullit, por edhe ide e ndoshta edhe vepra të vyera të Gazullit, të cilat me siguri ishin dërguar në bibliotekën e Matias Korvinit me urdhër të mbretit. Libri i Ptolemeut në latinisht, të cilin e përmend edhe Regiomontanus-i, mund të ketë qenë një tjetër libër i rëndësishëm i Gazullit në bibliotekën Korviniane. Ptolemeu ishte një raritet në atë kohë, dhe nuk ekzistonte akoma në Europën Qendrore, edhe pse ishte shkruar që në shekullin e dytë pas Krishtit. Fakti që në Europën Qendrore nuk ekzistonte Ptolemeu në latinisht vjen nga kancelaria e vetë Matias Korvinit.⁵³

Që Gazulli e kishte *Gjeografinë* e Ptolemeut në bibliotekën e tij të pasur, të cilën siç do të shohim më poshtë ia la me testament qytetit të Raguzës, del krejt rastësisht një muaj pas vdekjes së tij. Më 16 mars 1465, Junius M. Georgio ishte përpjekur ta përvetësonte këtë “libër”, por meqenëse nuk e lejonte testamenti i Gazullit, sepse ai nuk përmendej si përfitues i këtij libri, Junius M. Georgio solli dy dëshmitarë për të provuar që Gazulli ia kishte lënë me gojë trashëgim librin. Fjala libër në këtë kontekst ka kuptimin e veprës së Ptolemeut, të kopjuar me shkrim dore nga vetë Gazulli apo nga ndonjë skrib i paguar prej tij. Bëhet fjalë për librin e famshëm *De descriptione orbis* të Claudius Ptolemeus-it, që në atë kohë ishte një raritet. Në bazë të dëshmimeve gojore, gjyqi vendosi t’ia japë librin Junius M. Georgio-s, por se çfarë ndodhi me këtë libër më vonë nuk dimë ende asgjë më shumë.

Arsyeja pse ky libër ishte raritet në latinisht, është se deri në atë kohë ekzistonte vetëm në greqisht. Edhe pse i shkruar në shekullin e dytë nga Ptolemeu, ai u përkthye për herë të parë në latinisht në vitin 1406 ose më 1407 nga Jacobus Angelus në Firence me titullin *Geographia Claudii*

⁵³ “In the list of works, which Regiomontanus proposed to edit, compose and publish, as given in MS. Vatican Palatine Latin 1375, fol. 176^v, - which I at present follow - and elsewhere, occurs the following item: “*De distinctione domiciliorum coeli contra CAMPANUM et JOANNEM GAZULUM*” (i. e. On distinguishing astrological houses against Campanus and John Gazulus). Can any reader of *Isis* supply further details concerning this Joannes Gazulus?” Lynn Thorndike & Solomon Gandz *et al.*, “Notes and Correspondence”, në *Isis*, vol. XXV, no. 2, A Journal of the History of Science Society, History of Science Society (Chicago: 1936): 449-460.

Ptolemaei,⁵⁴ dhe, duke qenë se pati një sukses të jashtëzakonshëm, që prej asaj kohe ishte një ndër titujt jashtëzakonisht të kërkuar, por që nuk ishte e lehtë ta kishe në dorë. Fakti që Gazulli e kishte atë në bibliotekën personale dhe me sa duket një kopje ia ka dërguar edhe bibliotekës së Matiasit, tregon se Gazulli kishte pasur akses në literaturën më bashkëkohore të kohës, si dhe mjetet apo mundësitë për ta bërë vetë kopjimin e tij ose për ta porositur kopjimin e tij, siç ndodhte rëndom për ata që i kishin mundësitë financiare.

Rrjeti akademik, i krijuar nga vetë librat e Gazullit

Biblioteka e Gjon Gazullit ishte ndër më të pasurat e kohës së tij. Nëpërmjet udhëtimeve dhe kontakteve, ai kishte arritur të kopjonte apo të blinte manuskriptet më me emër që ekzistonin në atë kohë. Të gjitha këto dorëshkrime, ai ia la me testament Republikës së Raguzës, duke krijuar kështu bibliotekën e parë publike në Raguzë. Në testament shkruhej shprehimisht që librat e tij duhej të vendoseshin në një vend ku të interesuarit të mund t'i lexonin dhe t'i konsultonin ato, por të mos mund t'i merrnin me vete në shtëpitë e tyre, apo t'i zotëronin ato. Librat e tij, krijuan kështu bibliotekën e parë publike në të gjithë Dalmacinë, sipas Aleksander Stipçeviqit. Ideja e bibliotekës publike që për ne është e vetëkuptueshme në ditët tona, në atë kohë ishte mjaft progresive, aq më tepër sepse dorëshkrimet ishin mjaft të kushtueshme dhe përbënin një pasuri të madhe monetare.

Librat zënë një vend të madh në testamentin e Gazullit. I shkruar më 17 shkurt 1465, dy ditë para se Gazulli të ndahej nga jeta, ai regjistrohet nga noteri publik më 19 shkurt në regjistrat e Republikës, e konkretisht në *Testamenta notaria* 18 (1462-1465), f. 126r-v si dhe në *Diversa Notariae*, vëll. XXXXVIII, f. 124v-125. Gazulli la në bibliotekën publike, në Katedralen e Shën Mërisë së Madhe (në Dubrovnikun e sotëm) të gjitha vëllimet e së drejtës kanonike dhe të shkrimeve të shenjta, me kushtin që ato të vendoseshin në një vend të zgjedhur nga prokurorët e kishës, “Ato nuk mund t'i jepen askujt në veçanti dhe as të përvetësohen nga askush, por duhet të qëndrojnë gjithmonë, siç u tha, në një bibliotekë [*in una biblioteca*] për lehtësinë e atyre që dëshirojnë të

⁵⁴ Richard J. A. Talbert & Richard Watson Unger, *Cartography in Antiquity and the Middle Ages: Fresh Perspectives, New Methods* (Leiden, Boston: Brill, 2008), 258-275.

lexojnë ose shohin ndonjë gjë.” Në këtë mënyrë, Gazulli krijoi bazat për një komunitet lexuesish, të cilët, në mënyrë direkte apo indirekte, do të ishin në kontakt edhe me njëri-tjetrin dhe jo vetëm me librat e tij dhe me botën e tij intelektuale. Librat që la Gazulli në vitin 1465 vunë themelet e bibliotekës shkencore në Dubrovnik, e cila ekziston edhe sot e kësaj dite në qytet.

Fakti që Gazulli zgjodhi katedralen e qytetit si vend ku të ruheshin librat, nuk është për t'u habitur: katedralja në Raguzë, ashtu si në shumë qytete të tjera perëndimore, konsiderohej si vendi më i sigurt në qytet. Duke i besuar katedrales ruajtjen e vëllimeve të tij me dorëshkrime, Gazulli thjesht po ndiqte një traditë të vetë qeverisë raguzane, e cila i ruante po aty dokumentet si dhe thesarin e saj. Të tjerë, veçanërisht priftërinjtë, ndoqën shembullin e tij. Kështu, në tetor të vitit 1473, presbiteri Nicolas Djončić, “*decretorum doctor*” dhe ish-drejtor i shkollës së mesme të Raguzës, në testamentin e vet ia la të gjithë librat e tij juridikë kishës së Shën Marisë së Madhe, me të njëjtat kushte si ato të Gjon Gazullit.

Disa nga librat, Gazulli urdhëroi të shiteshin nga përmbaruesit e testamentit të tij, me qëllim që të shlyheshin borxhet që kishte. Nga pjesa tjetër e testamentit është evidente se Gazulli priste që me përjashtim të librave të dhuruara bibliotekës, të tjerët të shiteshin dhe të ardhurat prej tyre t'u jepeshin trashëgimtarëve të tij. Për këtë arsye, sot nuk mund të themi me saktësi se sa libra zotëronte Gazulli, kur ishte gjallë. Në një kohë kur librat shkruheshin e kopjoheshin vetëm me dorë, ata kishin një vlerë jashtëzakonisht të madhe materiale. Me siguri që jo të gjithë librat ishin kopjuar nga vetë Gazulli, por shumë prej tyre ishin porositur përkundrejt pagesës që të kopjoheshin për të në qendrat e djes e të kulturës ku ai kishte qenë vetë fizikisht, por jo vetëm.

Gazulli la edhe shumë libra në vendet ku kishte jetuar e punuar, si p.sh. në Padova, në manastirin e Shën Justinës në Romë, në Sienë e në vende të tjera. Dimë p.sh. që dorëshkrimet e tij ishin në duart e Regiomontanus-it, të Jan Pannonius-it, madje edhe në koleksionin e Peurbach-ut, siç konstanton Jurić-i, i cili thotë se në veprën e *Theoricae novae planetarum*,⁵⁵ të Peurbach-ut që ruhet në bibliotekën universitare

⁵⁵ Peurbach, *Theoricae novae planetarum* (Venice, 1482, 1485, 1488, 1490, 1491 and 1499).

të Krakovit ka gjetur një shënim dhe një vizatim që duket si i Gazullit.⁵⁶ Dhe nuk është për t'u çuditur. Kur Mbreti hungarez, Matias Korvini e ftoi Gazullin me anë të një letre që daton 26 prill 1459, ai e quan atë *magister Johannes astronomus*,⁵⁷ gjë që tregon për një reputacion të konsoliduar tashmë të Gazullit.

Jo vetëm sasia e librave të Gazullit ishte impresionuese, por edhe cilësia e tyre. Ndër ta, p.sh. ishte *Magister Sententiarium*, i Petrus Lombardus-it, i cili ishte huazuar (sipas testamentit të tij) nga don Nicolaus Tanussius (don Nikollë Tanushi) që prej 8 vjetësh. Me sa duket, Gazulli ishte shumë fanatik për librat e tij, sepse edhe pas vdekjes kërkon që ky libër të kthehet te koleksioni i tij, gjë që e shkruan në testament. Kjo është akoma më e vërtetë, po të kemi parasysh faktin që Nikollë Tanushi ishte një njeri i rëndësishëm për Gazullin, përderisa e kishte zgjedhur të ishte përmbarues i testamentit të tij.

Gazulli ishte besnik ndaj atyre që i kishin huazuar libra për t'i kopjuar. Kështu, një ndër arkat me dorëshkrime e kishte marrë nga mjeshtri Stefanus Albanensis dhe mbante titullin "*Diversa volumina librorum spectantia ad facultatem gramaticalem, rethoricalem et poeticam.*" Këto dorëshkrime ishin në greqishten e vjetër dhe në latinisht, dhe përmbanin traktate filozofike e letrare. Nikollë Tanushi ia ktheu këto dorëshkrime pronarit në Padova më 12 qershor 1468, një gjest që tregon se edhe pas vdekjes ato liheshin me amanet që t'i dorëzoheshin pronarit. Është pikërisht kjo besnikëri e Gazullit ndaj miqve të tij, që e kishte bërë atë të gëzonte respektin dhe besimin e personaliteteve të ndryshme, të cilat nuk kishin frikë t'i jepnin atij jo vetëm dorëshkrime nga më të rëndësishmet, por t'i besonin edhe misione diplomatike nga më delikatet e të rëndësishmet, që përcaktonin marrëdhëniet ndërkombëtare të Raguzës me gjithë fuqitë e asaj kohe të Europës e më gjerë.

Jo vetëm biblioteka e tij personale ka përfituar mjaft nga ky reputacion i Gazullit, por edhe gjithë qyteti i Raguzës, skribët e të cilit kopjonin çdo gjë që sillte Gazulli. Katalogu i Anton Koberger-it, që daton nga viti 1480 i librave dhe dorëshkrimeve të domenikanëve të Raguzës, tregon qartë për pasurinë e jashtëzakonshme të bibliotekës së dominikanëve, ndër të cilat ishin edhe dy vepra të Ptolomeut, një poemë astronomike e filozofit dhe astrologut hebre Abraham Ibn Eser, dy vepra

⁵⁶ Jurić, *Prilozi*, 458.

⁵⁷ *DAD, Lettere et commissiones Levantis XVI* (1454-1460), fol. 64^r; Jurić, *Prilozi*, 475.

të astronomit arab Abumasar, veprat e Regiomonanus-it dhe të Peurbach-ut etj.⁵⁸ Përveç këtyre kishte edhe shumë vepra të tjera shkencore, si *Concordia super physica e liber coeli et mundi* të Ibn Sina, i njohur si Avicena,⁵⁹ komente të veprave të Aristotelit etj.⁶⁰ Në këtë mënyrë, dashje pa dashje, nën ndikimin e Gjon Gazullit, Republika e Raguzës ishte shndërruar në një nga qendrat kryesore të kulturës e të shkencës në Europë, duke fituar një reputacion shumë të lartë në matematikë dhe në astronomi, ku ylli më shndritës ishte pa dyshim Gjon Gazulli.

Bibliografi:

Burime arkivore:

Državni Arhiv u Dubrovniku (DAD), Fondi (F) Bassegli-Gozze, Rukopisi, XXXII, 271^r-281^v.

Botime dokumentare:

Miklosich, Franc. *Monumenta Serbica spectantia historiam Serbiae, Bosnae, Ragusii*. Viennae: Apud Guilelum Braumüller, 1858.

Gelcich, Giuseppe. & Thallöczy, Ludevit. *Raguza és Magyaroszàg. Összeköttetéseinek Oklevéltàra. A Raguzai àllami, a Bécsi Cs. És Kir. Titkos és egyéb Levéltàrakban levő okiratokból (Diplomatarium Relationum Reipublicae Ragusanae cum Regno Hungariae)*. Budapest: Kiadaja a M. Tud. Akadémia Tört. Bizottsàga, 1887.

Gjergj Kastrioti – Skënderbeu në fondet e Arkivit Shtetëror të Dubrovnikut. Dokumente. Hulumtoi dhe përgatiti Gjon Berisha. Instituti i Historisë “Ali Hadri” – Prishtinë. Prishtinë: IH, 2018.

Zamputi, Injac. *Regjistrimi i Kadastrës dhe i Koncesioneve për rrethin e Shkodrës 1416-1417*. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, 1977.

⁵⁸ Žarko Dadić, “Položaj matematike, fizike i astronomije u kulturnoj prošlosti Dubrovnika i doprinos Dubrovčana tim znanostima (do početka XIX. stoljeća)”, *Rasprave i građa za povijest nauka*, vol. III (Zagreb: 1969), 5-73.

⁵⁹ Josip Badalić, *Inkunabule u Narodnoj Republici Hrvatskoj*, Djela Jugoslovenske Akademije Znanosti i Umjetnosti, knj. XLV. (Zagreb: JAZU, 1952), 5.

⁶⁰ Mirko Dražen Grmek, “L’apport de Dubrovnik aux sciences mathématiques et physique jusqu’à l’époque de Bošković”, *Actes du Symposium international R. J. Bošković 1961* (Beograd: Conseil des Academies RPFY, 1962), 243-254.

- Valentini, Josephi S. J., *Acta Albaniae Veneta Saeculorum XIV et XV. Labore reperta et transcripta ac typis mandata. Pars Secunda. Saeculi XV parascanderbegianam periodum complectens. Tomus Octavus. Ab anno MCDVII ad MCDIX. München: Rudolfo Trofeniko editore, 1970.*
- Gelcich, Josephus. “Monumenta Ragusina (Libri Reformationum)”. *Monumenta Spectantia historiam slavorum meridionalium*, Volumen Vigessimus Nonum. Academia Scientiarum et Artium Slavorum Meridionalium, Tomus V, ann. 1301-1336. Zagreb: Ex Officina Societatis Typographicae, 1897.
- Radonić, Jovan. “Đurađ Kastriot Skenderbeg i Arbanija u XV veku”. In *Spomenik XCV*, Istoriska građa. Drugi razred, knj. LXXIV, Srpska Kraljevska Akademija. Beograd: SKA, 1942.
- Radonić, Jovan. *Acta et diplomata Ragusina. Fontes rerum Slavorum Meridionalium (Dubrovačka akta i povelje. Izvori za istoriju južnih slavena)*. Series Prima. Tomus I, fasciculus 2. (Uređuje, sabrao i objavio, Jovan Radonić. Serija prva, knjiga I, sveska 2. Srpska Kraljevska Akademija. Zbornik za Istoriju, jezik i književnost srpskog naroda. Treće odeljenje, knjiga III. Beograd: SKA, 1934.
- Stojanović, Ljubomir. *Stare srpske povelje i pisma*, Knjiga I-II. Beograd-Sremski Karlovci: SKA, 1934.
- Grmek, Mirko Dražen. & Dadić, Žarko. “O astronomu Ginu Gazulu i dubrovačkom traktatu o astrolabu. (L’Astronome Gin Gazul et le traite Ragusain d’Astrolabe)”. *Anali Zavoda za povijesne znanosti Hrvatske Akademije Znanosti i Umjetnosti u Dubrovniku*, Istorijski Institut u Dubrovniku, viti XIII-XIV. Dubrovnik: 1976.
- Србскии споменици или старе рисовулѣ, дипломе, повелѣ, и сношенія босански, сербски, херцеговачки, далматински, и дубровачки кралѣва, царева, банова, деспота, кнезова, войвода и властелина. Часть 1 / собрани трудомъ Павла Карано-Твртковића Свештеника. У Београду: У Типографіи Княжества Сербіе, 1840. (Monumente serbe ose krisobula të vjetra, diploma dhe akte të mbretërve, perandorëve, banëve, despotëve, princave, dukëve dhe zotërve boshnjakë, serbë, hercegovinas, dalmatinas dhe dubrovnikas, vëll. I. Mbledhur dhe përgatitur nga prifti Pavla Karanotvrtković. Beograd: Tipografia e Principatës së Serbisë, 1840).*
- Jurić, Šime. “Prilozi biografiji Ivana Gazulića”, *Anali Zavoda za povijesne znanosti Hrvatske Akademije Znanosti i Umjetnosti u Dubrovniku*. Istorijski Institut u Dubrovniku, VIII-IX, 1962.
- Nodilo, Speratus. “Chronica Ragusina Junii Restii. (Ab origine Urbis usque ad annum 1451). Item Joannis Gundulae. (1415-1484)”. *Monumenta*

spectantia historiam Slavorum meridionalium. Volumes XXV. Scriptores. Volumen II. Digessit Speratus Nodilo. Edidit Academia Scientiarum et Artium Slavorm Meridionalium. Zagabriae: Ex Officia Societatis Typographicae, 1893.

Literaturë historiografike:

- Stipčević, Aleksander. “Ideja o javnoj knjižnici u renesansnom Dubrovniku”. *Vjesnik bibliotekara Hrvatske*, vëll. XL, nr. 1-2. Zagreb: Nacionala i Sveučilišna knjižnica u Zagrebu, 1997.
- Stipčević, Aleksander. *Socijalna povijest knjige u Hrvata*, Knjiga I, Srednji vijek. Zagreb: Skolska Knjiga, 2004.
- Carr, Amelia J. & Richard L. Kremer. “Child of Saturn. The Renaissance Church Tower at Nideraltaich”. *The Sixteenth Century Journal*, vëll. XVII, nr. 4. Kirksville, /Missouri/: Truman State Universsity, 1986.
- Šoljić, Ante. “O ranoj renesancu u Dubrovniku. (Early Renaissance in Ragusa (Dubrovnik))”. *Anali Zavoda za povijesne znanosti HAZU u Dubrovniku / Annals of the Institute for historical sciences of CASA in Dubrovnik*, viti XL. Dubrovnik: Zavod za povijesne znanosti HAZU Dubrovnik, 2002.
- Favaro, Antonio. “I lettori di matematiche nelle Università di Padova”. *Memorie e Documenti per la Storia dell’Università di Padova*, vëll. I. Padova: La Garangola, 1922.
- Aurel Plasari, *Skënderbeu: Një histori politike*. Tiranë: Instituti i Studimeve Shqiptare “Gjergj Fishta”, 2020.
- Kren, Claudia. “Planetary Latitudes, the *Theoretica Gerardi* and Regiomontanus”. *Isis*, vol. LXVII, nr. 2. A Journal of the History of Science Society. History od Science Society. Chicago: The University of Chicago Press 1977.
- Csapodi, Csaba & Csapodiné Gárdonyi, Klára & Szántó, Tibor. *Bibliotheca Corviniana: The Library of King Matthias Corvinus of Hungary*. Përktheu Zsuzsana Horn. New York: Frederik Praeger, 1969.
- Hayton, Darin. “Expertise *ex Stellis*: Comets, Horoscopes, and Politics in Renaissance Hungary”. *Osiris*, History of Science Society, vëll. XXV, nr. 1. Chicago: Chicago Press, 2010.
- Malaj, Edmond. “Marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare ndërmjet Raguzës dhe trojeve arbërore”. *Studime historike*, viti LXXXV (LVIII), nr. 1-2/2021. *Enciklopedija Jugoslavije*. Miroslav Krleža (ed.) *Dip-Hiđ*. Jugoslavenski Leksikografski zavod, vëll. III. Zagreb: Leksikografski Zavod FNRJ, 1958.
- Zinner, Ernst. *Leben und Werken des Johannes Müller von Königsberg gennant Regiomontanus*. Osnabrück: O. Zeller, 1968.

- Lala, Etleva. “Arkivat e Penitencierisë së Shenjtë Apostolike dhe një rast aborti në Pultin e Poshtëm”. *Revista Kosova*, 47 (2022).
- Lala, Etleva. “Zbulohet në Dubrovnik studimi i Gjon Gazulit për astronominë. Dokument i rrallë i shekullit XV zbulon një tjetër dimesion të priftit të devotshëm. Dorëshkrimi i panjohur”. Në *Rilindasi*. Supplement i së dielës te Shqiptarja.com, viti IV, nr. 53. Tiranë: Shqiptarja.com, (28 dhjetor 2014).
- Fjalori Enciklopedik Shqiptar*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2008.
- Banfi, Florio. “Ma i moçmi humanist shqiptar: Joannes Gazulus, shek. XV (Antiquissimus humanista albanensis, Joannes Gazulus, saec. XV)”. *Leka*, E perkohshme muejore e Shoqatës “L.E.K.A.”, vjeti XI, nr. 1-2. Shkodër: 1939.
- Appendini, Francesco Maria. *Notizie storico-critiche sulle antichità storia e letteratura de' Ragusei*, vol. II. Ragusa: Delle Stampe di Antonio Martecchini, Con Licenza de' Superiori, 1803.
- Iunctino, Francisco & Valesii, Francisco. *Speculum Astrologiae universam Mathematicam scientiam, in certas classes digestam*. Tomus Prior. Lugundi: In Officina Q. Phil. Tinghi Florentini: Apud Simphorianum Beraud. Cum Privileg. Caes. Maiest. et Reg. Christian, 1581.
- Florentismo, Franciscus Iunctino. *Speculum astrologiae quod attinet ad Iudiciariam rationem nativitatum atque annuarum reuolutionum: cum nonnullis approbatis Astrologorum sententiis*. Lugundi: Sumptibus Philippi Tinghi Florentini, Cum Privilegio Regio, 1573.
- Cordignana, Fulvio. & Valentini, Giuseppe. *Saggio di un regesto storico dell'Albania*. Scutari: Tipografia dell'Immacolata, 1937-1940.
- Cordignano, Fulvio. *L'Albania a traverso l'opera e gli scritti di un grande Missionario italiano il P. Domenico Pasi, S.I. (1847-1914)*. Roma: Istituto per l'Europa Orientale, 1933.
- Zonta, Gaspare & Brotto, Ioanne. *Acta Graduum Academicorum Gymnasii Patavini ab anno 1406 ad annum 1450 Cum aliis antiquioribus in Appendice additis iudicio historico collecta ac digesta curantibus*. Editio Altera. III. Index Nominum. Istituto per la Storia dell'Università di Padova. Padova: Editrice Antenore, 1970.
- Peuerbach, Georg. *Theoricae novae planetarum*. Venice: 1482, 1485, 1488, 1490, 1491, 1499).
- Riccioli, Giovanni Battista. *Almagestum novum: astronomiam veterem novamque complectens observationibus aliorum, et propriis novisque theorematibus, problematibus, ac tabulis promotam, opus absolutum quorum argumenta sequens pagina docebit*, vol. I. Bologna: Apud Joannem Beyerum per venales habentur, 1653.

- Musanti, Giovanni Domenico. *Tabulae Chronologicae Jo: Dominici Musantii e Societate Jesu quae Sacra, politica, bellica, fortuna, literas, et artes ad omnigenam historiam complectum*. Editio tertia. Amplissimo praesuli Nicolo Spineli episcopo Aversano D.D.D. Romae: Excudebat Joannes generosus Salolmoni. In Foro S. Ignatii. Superiorum Permissu, 1750.
- Berisha, Gjon. *Arbërorët ndërmjet kishës perëndimore dhe asaj lindore gjatë shekujve XI-XV*. Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri,” 2015.
- Riccolus, Ioanne Baptista. *Almagestum novum astronomiam veteram novamque complectens observationibus aliorum et propriis. Nouisque Theorematis, Problematis ac Tabulis promotam, in tres tomos distributam quorum argumentum*. Bononiae: Ex Typographia Haeredis Victorij Benatij, 1651.
- Mahnken, Irmgard. “Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern während des Mittelalters. Randbemerkungen zur Problematik der balkanologischen Forschung”, *Beiträge zur Südosteuropa Forschung. Anlässlich des I. Internationalen Balkanologenkongresses in Sofia 26. VIII, 1. IX. 1966. Arbeitskreis Südosteuropa-Forschung bei der Deutschen Forschungsgemeinschaft*. München: Trofenik, 1966.
- Božić, Ivan. “Dubrovnik i Turska u XIV. i XV. veku”. *Posebna izdanja, CC*. Srpska Akademija Nauka. Istoriski Institut. Knj. III. Beograd: Naučna knjiga, 1952.
- Drançolli, Jahja. *Gjin Gazulli, Astronom dhe diplomat i shek. XV*. Prishtinë: Rilindja, 1984.
- Pannonius, Janus. *Opuscularum. In qua exhibentur pauca quaedam e Plutarcho et Demosthene in Latinum eodem interprete translata, nec non orationes ejus et epistolae*. Pars altera. Traiecto ad Rhenum /Utrecht/: Apud Bathol. Wild. Bibliop., 1784.
- Tadić, Jorjo. “Johannes Gazulus, dubrovački humanista XV veka”. *Enciklopedija Jugoslavije*. Miroslav Krleža (ed.) *Dip-Hiđ*. Jugoslavenski Leksikografski zavod, vol. III. Zagreb: Leksikografski Zavod FNRJ, 1958.
- Jireček, Konstantin. “Die Romanen in den Städten Dalmatiens während des Mittelalters”, *Denkschriften Österreichische Akademie der Wissenschaften*. Philosophisch-historische Klasse, vol. XLVIII, part III. Vjenë: In Commission bei C. Gerold's Sohn, 1904.
- Thorndike, Lynn & Gandz, Solomon *et al.*, “Notes and Correspondence”. In *Isis*, vol. XXV, no. 2. A Journal of the History of Science Society, History of Science Society. Chicago: 1936.
- Grmek, Mirko Dražen. “L’apport de Dubrovnik aux sciences mathématiques et physique jusqu a l’époque de Bošković”. In *Actes du Symposium*

- international R. J. Bošković 1961*. Beograd: Conseil des Academies RPFY, 1962.
- Grmek, Mirko Dražen. "Pregled povijesnog razvitka prirodnih nauka kod Hrvata od VIII. do XVIII. Stoljeća". In *Hrvatsko kolo*, viti V, vëll. IV. Zagreb: Matica Hrvatske, 1952.
- Swerdlow, Noel M. "Regiomontanus on the Critical Problems of Astronomy". *Nature, Experiment and the Sciences: Essays on Galileo and the History of Sciences*. Boston Studies in the Philosophy and History of Science, vol. CXX, Boston: Springer, Dordrecht, 1990.
- Talbert, Richard J. A. & Unger, Richard Watson. *Cartography in Antiquity and the Middle Ages: Fresh Perspectives, New Methods*, Leiden, Boston: Brill, 2008.
- Cerva, Serafinus Maria (Serafin Marija Crijević), *Biblioteca Ragusina. In qua Ragusini scriptores gesta et scripta recensentur. Editionem principem curavit et prooemium conscripsit. Stepanus Krasić, Volumen II*. Zabreb: Academia Scientiarum et Artium Slavorum Meridionalium, 1977.
- Dadić, Žarko. "Položaj matematike, fizike i astronomije u kulturnoj prošlosti Dubrovnika i doprinos dubrovčana tim znanostima (do početka XIX. stoljeća)". *Rasprave i građa za povijest nauka*, vëll. III. Zagreb: JAZU, 1969.
- Dadić, Žarko. *Egzaktne znanosti hrvatskoga srednjovjekovlja*. Zagreb: Globus, 1991.

ETLEVA LALA, PHD

Eötvös Loránd University (ELTE)

lala.ettleva@btk.elte.hu; ettlevalala@yahoo.com

S u m m a r y

JOHANNES GAZULUS

THE MASTER OF SOCIAL NETWORKS IN THE MIDDLE AGES

Johannes Gazulus was a famous Albanian astrologer who lived and worked in the fifteenth-century Ragusa. In this article, his profile is visited from a different perspective, namely as a master of social networks in the Late Middle Ages. In this respect, the following networks are highlighted: 1. His Albanian social network in the Republic of Ragusa and beyond; 2. His local Ragusan network especially with the Ragusan Senate, who entrusted him the

delicate mission of acquiring from the Holy See a special privilegium to trade with non-Christians; 3. His political connections with the Hungarian king and Roman Emperor, Sigismundus of Luxemburg, which made him a name as a successful negotiator and mediator. One of these roles was also making the Ottoman threat relevant for the Holy See, which resulted into a large anti-Ottoman campaign during the Holy Year 1450-1451. 4. The political connections are treated as a separate network, and last but not least, I take into consideration the intellectual network of Gazulli. 5. The intellectual network included not only scholars, professors and students, but also extends to the readers of his books and ideas, making his legacy last forever.

